



Mundësi e "artë" financimi për kompanitë e peshkimit - Kriteret/ Cilat përfitojnë grante deri në 50 % për investime në anije

Faqe 7



Gjendja e grave në zonat rurale në veri të Shqipërisë

Faqe 6



Alarmi shqetësues i KE: Shqipërisë po i "gërryhet" toka - Fenomeni shumë agresiv! Vetëm 2.6 % përdoret për bujqësi organike

Faqe 4



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit korrik 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 441
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur



SHQIPËRIA DHE KOSOVA NEVOJË PËR STRATEGJI TË KOORDINUARA TË ZHVILLIMIT BUIQËSOR - RRAPAJ: HAPJA E DREJTË E TREGJEVE KËRKON BARAZIM TË SUBVENCIONEVE

Nga Revista "Monitor": Intervistë me Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Falë këshillimit në karrierë, Ismaili po merr një vendim për profesionin e tij të ardhshëm

Shërbimet e karrierës janë thelbësore për të lehtësuar kalimin e studentëve nga universiteti drejt tregut së punë



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



GIZ

"Shqipëria, potencial për rritje, nga agroturizmi tek energjia"

Faqe 5

KËNDI I EKSPERTIT

- Kujtesë këshilluese për fermerët mbi ruajtjen dhe depozitimimin e grurit në fermë Fq.11
- Këshilla për fermerët kultivues të mollës, për periudhën korrik 2022 Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta Fq.12
- Këshilla për fermerët kultivues të mollës, për periudhën korrik 2022 Fq.12
- Bujqësia dhe ndryshimet klimatike - Nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.14

Kim viziton Shëngjergjin, njihet me përvojën e grave në sipërmarrjet agroturistike

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Yuri Kim vizitoi fshatin e bukur të Shëngjergjit dhe u takua me pronarë biznesesh rreth Tiranës, të cilat marrin pjesë në nismën Gratë në Zhvillimin Rural...



Faqe 4

DRITHËRA

Kriza globale e grurit, Krifca: Nuk kemi varësi totale nga Ukraina, po kërkojmë tregje të tjera



Faqe 4

TEMË E DITËS

Fermeri italian që la Italinë për Shqipërinë: Çmenduri, tregtarët shqiptarë grurin e vendit të tyre e blejnë në Itali me çmim dyfish

Faqe 7

RISI ALBANIA

Falë këshillimit në karrierë, Ismaili po merr një vendim për profesionin e tij të ardhshëm

Shërbimet e karrierës janë thelbësore për të lehtësuar kalimin e studentëve nga universiteti drejt tregut së punë

Shërbimet e karrierës janë thelbësore për të lehtësuar kalimin e studentëve nga universiteti drejt tregut së punës, ndërsa këshilluesit e karrierës në UAMD janë guri i themelit të këtyre shërbimeve.

Përgjatë dy javëve, Ismail Thaçi nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit, ndoqi një trajnim profesional ku nëpërmjet ushtrimeve praktike mësoi më shumë rreth profesionit të këshilluesit të karrierës dhe u pajis me njohuri dhe instrumenta për t'i aplikuar gjatë punës së tij me studentët.

Tashmë i gjithë stafi i Karrierës UAMD është i trajnuar falë mbështetjes së RISIA Albania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Një vend të rëndësishëm në shërbimet e karrierës së edhe sektori rural

Tema e këshillimit të karrierës në nivel Universitar është

versitar", shprehen pedagogë të universitetit Bujqësor.



Procesi i këshillimit në karrierë i ndihmon adoleshentët të kuptojnë se ata janë përgjegjës për menaxhimin e karrierës së tyre dhe u jep atyre mundësinë të njohin dhe zhvillojnë aftësitë që u nevojiten

Çështja e përfshirjes së të rinjve në proceset ekonomike-bujqësore është veçanërisht e rëndësishme pasi hulumtimet tregojnë se të rinjtë janë më të

e punës, duke theksuar rolin që kanë qendrat e këshillimit

të karrierës në orientimin e të rinjve drejt arsimit të duhur, trajnimit dhe zgjedhjes së karrierës.

Studentët e asistuar nga këshillimi i karrierës, pajisjen edhe me certifikatën e profesionistit, si elementi që i motivon dhe ndihmon studentët të gjejnë punën për të cilën janë kualifikuar. Teksa midis këtyre studentëve dhe sipërmarrjes,



fokus kryesor i projektit RisiAlbania që i kushton shumë rëndësi shkëmbimit të eksperiencave mbi shërbimet e këshillimit të karrierës. Ndërsa shihet ndër të tjera edhe si një mundësi e mirë për të diskutuar midis aktorëve të fushës për statusin aktual dhe të ardhshëm të këshillimit të karrierës në Shqipëri dhe një mundësi për të prezantuar punën që po bën RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për të siguruar një orientim cilësor për të rinjtë shqiptarë në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional si për të siguruar lidhjen me tregun e punës.

"Ne po forcojmë shërbimet e këshillimit të karrierës në universitetin tonë, me mbështetjen e projektit RisiAlbania, dhe tani është momenti të ofrojmë më shumë shërbime si praktikant mësimor dhe të zhvillojmë rrjetet alumni. Është me shumë rëndësi që këto shërbime të ofrohen edhe në nivelin parauni-

shqetësuar për situatën ekonomike dhe pasigurinë e madhe në lidhje me gjetjen e një vendi pune.

Nisma e RisiAlbania për këtë çështje të rëndësishme, që ka të bëjë me punësimin e të rinjve, është mbështetur edhe nga përfaqësuesit e universiteteve dhe bizneseve private, të cilët me shumë dëshirë u janë bashkuar diskutimeve të përbashkëta, për të mbështetur kalimin e të rinjve nga sistemi arsimor në tregun

qëndron një hallkë e rëndësishme, shërbimi i këshillimit të karrierës.

Pas programit ndërkombëtar të trajnimit (GCDF), dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të qendrave të këshillimit të karrierës, universitetet po bashkëpunojnë më tej me RisiAlbania për të forcuar shërbimet aktuale dhe për të prezantuar shërbime të reja si trajnime, panairt e karrierës, krijimin e Rrjetit të Alumni dhe të tjera si këto.



DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Enio Jaço: Bizneset e ndershme po paguajnë koston e ekonomisë së zezë

Presidenti i Dhomës Amerikane, Enio Jaço deklaroi se Shqipëria duhet të orientojë politikën drejt mundësive eurotransatlantike dhe që të përfitojë prej tyre, duhet të luftojë ekonominë e zezë, informale, koston e së cilës, e paguajnë bizneset e ndershme dhe e marrin në konsideratë investitorët të huaj potencialë. Ai kërkoi që qeveria të bëjë më shumë përpjekje për të ç'rrenjosur ekonominë e zezë duke pranuar programet perëndimore mbi praktikën kundër pastrimit të parave.

dhe pakënaqësi me politikën e brendshme të vendit. Indeksi i Biznesit, matësi vjetor i AmCham tregon se shumë shpesh praktikën në mënyrën e të bërit biznes nuk janë të drejta. Si rrjedhojë e kësaj situate, talente të reja profesionale janë duke parë mundësitë e largimit nga Shqipëria. Nëse duam të ndërtojmë vërtetë një ekonomi konkurruese, kjo është një kosto për të gjithë ne – përfshirë bizneset tona" u shpreh Presidenti i AmCham.

Enio Jaço bëri një analizë të situatës ku operojnë bizneset,

detyrueshëm por ne e inkurajojmë atë, që të bëjë më shumë përpjekje për të ç'rrenjosur ekonominë e zezë duke pranuar programet perëndimore mbi praktikën kundër pastrimit të parave. Këto masa do të rrisnin interesin e investitorëve seriozë drejt Shqipërisë".

Duke u ndalur tek investimet amerikane në Shqipëri, Jaço i uroi mirëseardhjen kompanisë amerikane Bechtel si anëtar i ri i Dhomës Amerikane dhe shprehu optimizëm se me klimën e duhur të tjera investime amerikane do bëhen realitet në Shqipëri.

"Koorporata Bechtel do të realizojë një nga projektet më strategjik të energjisë në Skavicë, me një impakt të jashtëzakonshëm në ekonomi dhe turizëm. Dhe përveç Bechtel, dy gjigandë të tjerë amerikanë, Exxon Mobile dhe Accelerate janë duke përparuar me eksplorimin e një tjetër projekti domethënës energjetik. Vetëm këto dy projekte do të kenë impakt domethënës në ekonomi dhe në krijimin e vendeve të reja të punës, por shpresoj që këto të jenë dy projektet e para dhe të tjerë do të vijnë në vijim" tha Presidenti i AmCham.

Jaço e mbylli fjalën me Axhendën e Investimeve, paketën e AmCham me 40 ndërhyrje ligjore për përmirësimin e klimës së biznesit me thirrjen për të punuar bashkë me Qeverinë dhe forcat politike në Komisionet Parlamentare për implementimin e saj.

"Shpresoj që Axhenda e Investimeve do të implementohet. Ne presim të bashkëpunojmë me Qeverinë, Ministrinë e Financave dhe Parlamentin për ta kthyer atë në realitet. Ka ardhur koha që të ndalojmë së diskutuari problemet e Klimës së Biznesit dhe të nisim ndërhyrjet konkrete ligjore për përmirësimin e saj, duke ofruar mundësi dhe zhvillim për të gjithë" tha Jaço.



Jaço foli gjatë Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së AmCham, në praninë e Ministres Ibrahimaj, Ambasadores Yuri Kim si dhe kompanive anëtare multinacionale të AmCham. Ai tha se në dy vitet e fundit Dhoma Amerikane ka rritur anëtarësinë e saj si dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë duke punuar me U.S. Chamber në Uashington si dhe Departamentin Amerikan të Shtetit për Tregtinë në mbështetje të rritjes së shkëmbimeve tregtare Shqipëri-SHBA.

Për sfidat që ka Klima e Biznesit sot, Jaço iu referua Indeksit Vjetor të AmCham, dhe krahas praktikave të padrejta, ngriti si shqetësim tendencën e largimit të talenteve të reja profesionale nga Shqipëria.

"Ka një shqetësim në rritje

një pjesë e të cilave, punojnë në atë që ai e quajti ekonomi të pastër penalizohen nga pjesa tjetër e ekonomisë informale. "Sot janë tre hije që karakterizojnë ekonominë shqiptare. Është ekonomia e bardhë, e cila është e pastër, por është edhe ekonomia gri dhe ajo e zezë. Dhe ju (anëtarët) punoni në ekonominë e pastër por jeni duke paguar koston e anës së errët të ekonomisë. Kjo nuk është e drejtë dhe duhet të marrë fund" tha Jaço duke iu drejtuar kompanive anëtare.

Ai kërkoi nga qeveria më shumë përpjekje në krijimin e praktikave të drejta, konkurruese dhe të ndershme: "Ne përgëzojmë Qeverinë për nismat në reduktimin e informalitetit të ekonomisë gri përmes faturimit elektronik të

Tirana mirëpret vjeshtën e këtij viti konferencën ndërkombëtare "Smart City"

Tirana do të mirëpresë vjeshtën e këtij viti konferencën ndërkombëtare "Smart City", një iniciativë kjo e Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe Industrisë, në vendin tonë, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit.

Presidenti i Dhomës Amerikane (AmCham) Enio Jaço, bëri të ditur, gjatë një konference për shtyp se në kuadër të kësaj konference do të jenë prezent në Shqipëri kompani të

mëdha në fushën e teknologjisë digjitale si Google, Amazon, Tesla, Microsoft, etj.

"AmCham në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit do të organizojë në shtatorin e këtij viti konferencën "Smart City". Kjo është një konferencë e rëndësishme rajonale që nuk ka ndodhur ndonjëherë në Shqipëri, e cila do të prezantojë disa nga teknologjitë digjitale më të avancuara. Për herë të

parë do të jenë prezent disa nga kompanitë më të mëdha amerikane në këtë fushë si Google, Amazon, Tesla, Microsoft, etj, që jo domosdoshmërisht janë shumë prezent në rajonin e Ballkanit në përgjithësi, por për herë të parë", tha Jaço.

Sipas tij, kjo konferencë do të ketë prezentë 20 krerë të bashkive të qyteteve më të mëdha të rajonit dhe Ballkanit Perëndimor.

????

SHQIPËRIA DHE KOSOVA NEVOJË PËR STRATEGJI TË KOORDINUARA TË ZHVILLIMIT BUJQËSOR

HAPJA E DREJTË E TREGJEVE KËRKON BARAZIM TË SUBVENCIONEVE

Nga Revista "Monitor": Intervistë me Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

Ndryshimet në subvencionim mes Shqipërisë dhe Kosovës mund të shtrembërojnë konkurrencën mes fermerëve të të dy vendeve.

Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit, thotë

nëse qëllimi është për të hequr tarifën për të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore, apo për produkte të veçanta.

Mund të ketë produkte që nuk na dëmtojnë as ne, as Kosovën, në shkëmbimet reciproke, ashtu siç ka të tjera që

produkte që kanë një moment të pikut të prodhimit të njëjtë, kjo do të krijonte konflikt tregtar, që duhet analizuar.

Më konkretisht, nëse ne importojmë nga Kosova mish, ky nuk do të ishte problem për blegtorët shqiptarë. 90% të sasisë së mishit ne e importojmë nga vende të tjera.

Nëse flasim pastaj, për shembull, për patatet, aty mund të kemi një problem. Sezoni i prodhimit është i njëjtë dhe këtu duhet parë sa subvencionon secila palë. Nëse ne e heqim tarifën, atëherë duhet të barazojmë subvencionimin. E njëjta logjikë vlen për specat. E njëjta gjë mund të vlejë për prodhimin e verës, që kërkon studime për të mos dëmtuar prodhuesit vendas.

Mendoj se kemi nevojë për strategji të koordinuar, në mënyrë që bujqësitë e dy vendeve tona të jenë komplementare. Kjo do të ishte në interesin e të dy vendeve.

Por, që të jemi realistë, ne kemi një problem shumë të madh me informacionin. Ne nuk dimë me saktësi çfarë mbjell Divjaka dhe çfarë mbjell Korça. Këtu do të ndihmonte shumë dixhitalizimi. Ne duhet të ndërtojmë platforma dixhitale, që të ndihmojnë për informacionin rreth bujqësisë. Në Shqipëri i kemi disa të tilla, por duhen pasuruar.

Nëse duam të ndërtojmë të tilla procese të hapjes së tregjeve, ne duhet të ndërtojmë platforma dixhitale që të ofrojnë informacionin e duhur. Nëse pastaj këtë e bëjmë për arsye politike, kup-

tohet që ekonomia udhëhiqet nga një logjikë tjetër dhe nuk do t'ia dijë për politikën.

konkurrenca, e cila duhet të jetë e ndershme. Kjo nuk ndodh gjithmonë dhe konkurrenca e

kontratave me Kosovën. Ka kompani kosovare që operojnë edhe në tregun tonë, me rezultate të mira. Këto kompani, ne duhet t'i mbështesim, sepse ato ndihmojnë dhe lehtësojnë proceset e unifikimit të tregjeve.

Mendoni se bashkërendimi i skemave të subvencionimit do të jetë element i domosdoshëm për të realizuar një hapje të drejtë të tregjeve mes dy vendeve?

Patjetër që është faktor i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me konkurrencën. Një marrëdhënie që bazohet në konkurrencë e pandershme nuk mund të vazhdojë gjatë. Subvencionin në vetvete e ka edhe këtë aspekt, faktin që shtrembëron konkurrencën mes prodhuesve të ndryshëm.

Nëse politikat e subvencionimit nuk janë të ngjashme dhe korrekte, sigurisht që në fund prodhohet konkurrencë e pandershme, në kushtet e tregjeve të hapura.

Çështja e dytë është baza e mbështetjes së kompanive importuese dhe eksportuese. Ne kemi kompani eksportuese më të zhvilluara në këtë sektor, e ndikuar edhe nga fakti që kemi mbështetur me përparësi qendrat e grumbullimit.

Nga ana tjetër, Kosova, mbështet më shumë blegtorin. Nëse kjo diferencë vazhdon gjatë, do të krijonte konkurrencë të pandershme, sidomos në blegtori.

për "Monitor" se Kosova ka një skemë subvencionimi që mbështetet në njësitë e shitura të produktit, e cila garanton mbështetje më të madhe, sidomos për sektorin e blegtorisë.

Sipas tij, Shqipëria dhe Kosova kanë nevojë për strategji të koordinuara të zhvillimit të bujqësisë, në mënyrë që prodhimi mes dy vendeve të jetë komplementar.

Çfarë efektesh mund të ketë heqja e njëanshme e tarifave doganore për hyrjen e produkteve kosovare në Shqipëri, kryesisht për sektorin bujqësor dhe agropërpunues?

Deklarata është e përgjithshme dhe nuk ka shumë elemente konkrete. Duhet parë

Çmimet e prodhimeve bujqësore u rritën mesatarisht me 7.4% vitin e kaluar raportoi INSTAT, por për disa artikuj si drithërat, bimët foragjere, frutat dhe ullinjë rritja ishte nga 12-28% (shih tabelën bashkëngjitur).

Në vitin 2021, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore arriti në 112,6 nga 104,8 që ishte në 2020, duke shënuar rritje me 7,4%.

Gjatë këtij viti, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 10,8%, gjithashtu rritje ka shënuar edhe indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale me 3,1%, krahasuar me një vit më parë.

Rritjen më të madhe vjetore e kanë shënuar çmimet e grupit "Patate", "Bimë foragjere", "Drithëra", "Drufrutorët",

mund të krijojnë probleme për prodhuesit shqiptarë.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është mbështetja, subvencionimi që iu jepet produkteve të Kosovës në raport me ato të prodhuara në Shqipëri. Fakti është se për shumë produkte, mbështetja me subvencione në Kosovë është më e madhe se në Shqipëri.

Skema që përdoret në Kosovë është skema e subvencionimit për njësi produkti. Ne kemi një skemë të ndryshme, të shpërndarë në shumë produkte, me kufizime në vlerë dhe e destinuar vetëm një numër të caktuar produktesh.

Element tjetër që ka shumë rëndësi lidhet me kohën e pikut të prodhimit. Nëse flasim për

Si do t'i vlerësonit, deri tani, rezultatet e marrëveshjeve Shqipëri-Kosovë, në drejtim të bashkëpunimit në fushën e bujqësisë dhe agrobiznesit, duke pasur parasysh edhe problemet e shfaqura në vitet e fundit, si për shembull ai i importit të patateve nga Kosova?

Mendoj se, në thelb, është

pandershme është e lidhur me të gjithë proceset që përmenda më sipër.

Ne duhet ta eliminojmë konkurrencën e pandershme brenda vendit, por edhe në marrëdhënien me Kosovën. Kjo është e rëndësishme.

Do të evidentoja se në vitet e fundit kemi pasur rezultate të mira në drejtim të lidhjes së



Indeksi i çmimeve bujqësore u rrit me 7% vitin e kaluar, për disa artikuj shtrenjtimi deri me 28%

"Perime", "Bimë Industriale", "Qumësht" dhe çmimet e grupit "Mish peshë e gjallë"

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standardet dhe rregullat e përkshuara në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mblidhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e vendit.

Mbledhja e të dhënave u krye pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjeve të shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen.

Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme



për produktet vendase, duke përjashtuar taksat. INSTAT

shpjegoi se ato janë llogaritur në Lek, kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë sipas produktit. Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore:

Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për mishin peshë e gjallë dhe prodhimet blegtorale.

Çmimet e mishit peshë e gjallë grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjalhtë.

Këtë vit indeksi i prodhimeve bujqësore pritet të ketë rritje edhe më të lartë për shkak se të gjitha prodhimet bujqësore dhe blegtorale kanë pësuar rritje jo të zakonshme prej rritje së çmimeve të lëndëve të para.

Bujqësia është dega kryesore e ekonomisë që kontribuon me rreth 20% të PBB-së, mbi 44 për qind të punësimin, po sektori vuan nga mungesa e mbështetjes së buxhetore, copëzimit të lartë të tokës dhe produktivitetit të ulët.

Alarmi shqetësues i KE: Shqipërisë po i "gërryhet" toka - Fenomeni shumë agresiv! Vetëm 2.6 % përdoret për bujqësi organike

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë dhe Shqipëria rrezikon të humbasë 1/3 e tokës bujqësore si pasojë e erozionit ujor. Ky paralajmërim shqetësues vjen nga një studim që ka realizuar Qendra e Përbashkët Kërkimore e Komisionit Evropian. Autorët e raportit paralajmërojnë se ky fenomen është shumë agresiv e si rrjedhojë, krahas erozionit ujor, sipërfaqja është në rrezik shkatërrimi në masën 45 % të saj edhe nga erozioni i tokës. Gjetjet u publikuan me rastin e Takimit Ministror të Platformave të Ballkanit Perëndimor.

Ndërkohë, vetëm 2.6% e sipërfaqes bujqësore përdoret për bujqësi organike, shumë larg objektivit të BE-së prej 25%.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, degradimi i tokës po zgjerohet në Ballkanin Perëndimor ndaj duhet të merren masa me qëllim që të amortizohen efektet e këtij procesi shkatërrimtar.

Raporti kishte në fokus

ndryshimet klimatike dhe impaktin në Ballkanin Perëndimor. Ajo që evidentohet në këtë raport është se ka një progres të kufizuar në mbrojtjen e mjedisit dhe klimës në Ballkanin Perëndimor



Ballkani Perëndimor ka bërë disa përmirësime në përafrimin e monitorimit të mjedisit dhe klimës, si dhe në raportimin e legjislacionit me standardet e BE-së. Zbatimi, megjithatë, është i parregullt, përfundon raportin në të cilin shprehet shqetësim për cilësinë e ajrit

dhe ujërave dhe për pasojat e rrezikshme të tyre në shëndet.

Për të mbështetur miratimin dhe zbatimin e acquis të BE-së, Komisioni Evropian propozoi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, duke



përshkruar një strategji rritjeje për rajonin, e cila bazohet në një ekonomi të qëndrueshme. Agjenda e Gjelbër synon ta përafrojë Ballkanin Perëndimor me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, duke e bërë Evropën një kontinent neutral ndaj karbonit deri në vitin 2050.

Pandemia nxiti prodhimin e bimëve të egra organike, rritje me 65% e sasisë më 2021

Prodhimi i bimëve organike të egra vitin e kaluar shënoi rritje vjetore me 65%.

Kjo rritje erdhi për shkak të kërkesës që pati tregu



ndërkombëtar për produktet organike, e cila ndikoi tek eksportuesit që të grumbullonin më shumë nga këto bimë.

E gjithë rritja erdhi nga bimët aromatike dhe mjekësore, teksa u pa një rënie e prodhimit të gështenjës dhe frutave të pyllit. Sipas INSTAT, prodhimi i bimëve aromatike dhe mjekësore në gjendje të egër arriti në 7608 tonë vitin e kaluar me një rritje 65 %.

Këto bimë dominohen nga sherebela dhe çajrat vendase. Ndërsa prodhimi i gështenjës ra me 8 % dhe i frutave të pyllit me rreth 1%.

Kudo në botë pandemia Covid-19 nxiti prodhimin e bimëve organike, për arsye se njerëzit konsumuan më shumë

"Bio" për të forcuar imunitetin. Për këtë arsye gjatë viteve 2020-2021 eksporti i bimëve medicinale organike që rritjen në gjendje të egër shënoi rritje



me ritme të larta.

Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike është një burim i rëndësishëm të ardhurash për një numër të madh familjesh në zonat rurale, veçanërisht në zonat malore të Shqipërisë.

Sipas studimeve të mëparshme ka deri 100,000 persona që përfitojnë nga rreth 20 000 familje që janë angazhuar në mbledhjen e tyre.

Qarku i Shkodrës radhitet i pari për pjesën kryesore në të ardhurat e fermave familjare, i ndjekur nga Elbasani dhe Kukësi. Të dhënat në nivel rrethi tregojnë se numri i fermerëve të përfshirë në veprimtaritë e bimëve të egra organike është shumë i lartë në Malësinë e Madhe, Kukës, Kolonjë dhe

Librazhd.

Rreth 90% e fermerëve që kultivojnë bimë mjekësore, kryesisht sherbele ndodhen në qarkun e Shkodrës (kryesisht Malësi e Madhe).

Megjithëse Shqipëria përballet me një deficit të lartë tregtar për shumicën e produkteve agro-ushqimore, ajo është eksportuese neto e bimëve mjekësore. Vendi ynë është një aktor ndërkombëtar në eksportet e tyre duke u renditur e 16-ta në botë.

Eksportet e bimëve mjekësore shënuan rritje 14% në 2020 kur nisi pandemia në raport me 2019, Sipas të dhënave të doganave, eksportet e bimëve mjekësore në vitin 2021 u rritën 6% krahasuar me vitin e kaluar.

Kryetari i Shoqatës së Bimëve Medicinale dhe Aromatike, Filip Gjoka, thotë se, për vitin 2022, trendi rritës i eksporteve 6%-7% do të mund të garantohej vetëm me rritjen e importit të bimëve mjekësore, pasi në vend ekziston mungesë e theksuar e lëndës së parë.

Për kreun e Shoqatës së Bimëve Medicinale është shqetësuese heqja e skemës së kreditueshme të TVSH-së 6%, që do të shtojë pesimizmin e fermerëve për të kultivuar tokat bujqësore. Arsyet tjetër e rënies së prodhimit vendas mbetet shpopullimi i zonave malore, por edhe ikja e fermerëve në emigracion.

Kim viziton Shëngjergjin, njihet me përvojën e grave në sipërmarrjet agroturistike

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Yuri Kim vizitoi fshatin e bukur të Shëngjergjit dhe u takua me pronare biznesesh rreth Tiranës, të cilat marrin pjesë në nismën Gratë në Zhvillimin Rural, e cila zbatohet nga Unioni i Bashkive të Shqipërisë, me mbështetjen e programit të granteve të vogla të Komisionit për Demokracinë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, njoftoi sot Ambasada e SHBA.

Gratë i treguan ambasadores Kim përvojën e tyre në ngritjen e sipërmarrjeve agroturistike, duke përfshirë bujtina, restorante dhe zeytari.

"Ne jemi krenarë që i mbësht-

tesim ato në ngritjen e bizneseve që do të tërheqin më shumë

e veçantë dhe mikpritjen e ngrohtë të Shqipërisë", njoftoi



turistë për të shijuar bukurinë e ambasadës amerikane.

Kriza globale e grurit, Krifca: Nuk kemi varësi totale nga Ukraina, po kërkojmë tregje të tjera

Ministrja e Bujqësisë, Frida Krifca ishte e ftuar në emisionin A2 Business ku foli rreth krizës

mëdha eksportuese përsa i përket shumë produkteve bazike.

Ministrja deklaroi se për

encës dhe vuri në dispozicion për importuesit instrumentin e garancisë bankare.

"Mentalisht nuk kemi një mungesë të produkteve ushqimore në tregje. Sigurisht Bordi i Transparencës së çmimeve ka pasur ndikimin e vet me sigurimin dhe vënien në dispozicion të instrumentit të garancisë bankare që iu vihet në dispozicion të importuesve si për vajin dhe për të frenuar rritjen e çmimit dhe abuzimin dhe për të garantuar që këto produkte nuk do të mungojnë", tha ministrja.

Sa i përket krizës së grurit, Frida Krifca u shpreh se Shqipëria nuk ka një varësi totale nga Ukraina apo Rusia për këtë produkt, por po mundohet të sigurojë tregje të tjera, por që është përballur me çmime të rritura në bursa.



së çmimeve dhe pasigurisë ushqimore që tashmë është shtuar në të gjithë botën për shkak të luftës në Ukrainë, e cila konsiderohet si një ndër vendet më të

momentin në Shqipëri, nuk ka një mungesë të produkteve ushqimore apo abuzim të tepërt me çmimet pasi qeveria mori masa duke ngritur Bordin e Transpar-

Zyrtarizohet krijimi i shoqatës së tregtisë online - Jaçe: Shqipëria, prapa. Problem, korniza ligjore. Kadia: Synojmë ekonomi të formalizuar

Shoqata e-commerce ka zyrtarizuar tashmë formimin e saj, ku janë bashkuar qindra subjekte që operojnë në tregtinë online brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në një konferencë të zhvilluar një ditë më parë përfaqësuesit e biznesit por dhe ekspertët shprehën problematikën dhe nevojat që ka ky treg.

Dhoma amerikane e tregtisë e ka cilësuar këtë sektor si të pra-

pambetur për shkak të të kornizave ligjore dhe mos njohjen e funksionimit të këtij tregu.

Ndërsa zv Ministri i Financave Besart Kadia tha se një plan veprimi do të funksionoj për vitet e ardhshme që do të ndihmojë këtë treg teksa u bëri thirrje bizneseve për formalizim.

Prioritet e ngritura në konferencë ishin rritja e besimit

të konsumatorit, i cili është i lëkundur për shkak të informalitetit që ekziston kryesisht në rrjetet sociale, ndërkohë që paralelisht kërkohet edhe rritja e standarteve për të vijuar me revolucionin digjital.

Brenda kësaj shoqatës së tregtisë online kanë lidhur bashkëpunimin edhe 8 kompani, të cilat procedojnë me pagesat.



“Shqipëria, potencial për rritje, nga agroturizmi tek energjia”

Shqipëria ka potenciale rritje në disa sektorë, duke nisur nga agroturizmi tek energjia, dhe politikat e mbështetja që jepet për to mund të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e jetesës së komuniteteve lokale në zonat rurale.

Për Dr. Sonja Kurz, Drejtore e Përgjithshme e GIZ Shqipëri,

tona partnere, si në nivel qendror edhe atë lokal, po punojmë për të krijuar perspektivë më të mirë për qytetarët shqiptarë dhe një të ardhme të qëndrueshme për vendin, bazuar në standardet e Bashkimit Europian.

Puna e GIZ në Shqipëri ka qenë e fokusuar në dy çështje parësore. E para është Zhvil-

lashtëzakonshëm të Shqipërisë për të siguruar të ardhura për popullsinë lokale.

Që nga viti 2019, 1460 fermerë të vegjël dhe Ndërmarrje të Mesme të Vogla kanë përfitur nga aksesit në masat financuese dhe kanë shtuar aktivitetet diversifikuese me të ardhura. Ne u kemi mundësuar që të përmirësojnë konkurrencën në Shqipëri dhe në tregjet rajonale.

Çështja e dytë thelbësore është Klima, Energjia dhe Tranzicioni, përfshirë Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban.

Në sektorin e Ujit, GIZ ka mbështetur 29 Ndërmarrje Ujësjellësi në ndërhyrje të ndryshme, që kanë rezultuar në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, infrastrukturë dhe shërbime për 1,595,156 persona në zona urbane dhe ka përmirësuar shërbimet e ujërave të përdorur për 896,527 individë.

Ekonomia qarkullues është zemra e modernizimit të menaxhimit të mbetjeve. GIZ mbështeti sektorin e menaxhimit të mbetjeve që nga viti 2016, për të përmirësuar shërbimet në të gjithë vendin, ku 6 nga 11 bashki janë mbështetur më konkretisht për të rritur shërbimet e mbulimit dhe për të organizuar riciklimin. Me mbështetjen e GIZ, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit tashmë ka një strategji kombëtare me kostot dhe masat konkrete, që synojnë arritjen e direktivave të BE-së dhe mbështetjen e negociatave të anëtarësimit.

Çështje të tjera të rëndësishme për GIZ janë barazia gjinore, mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, migrimi dhe mobiliteti urban. Në kontekst rajonal, ne kemi mbështetur fusha të tilla si promovimi i tregtisë së huaj, efienca e energjisë, shërbimet lokale dhe reforma ligjore.

limi i Qëndrueshëm Ekonomik, formimi profesional dhe promovimi i punës. Në këtë fushë, ne fokusohemi në rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive, përmirësimin e klimës së biznesit, nxitjen e punësimit dhe zhvillimit të aftësive dhe negociatave të anëtarësimit në kapitujt ekonomikë të Acquis të BE-së.

Si rezultat i kësaj, vetëm përmes projekteve nën këtë klaster, në tre vitet e fundit ne kemi nxitur sektorin privat dhe kemi siguruar punësim për 8200 persona, duke aplikuar konceptin e punëve të denja dhe përfshirëse.

Zhvillimi Rural dhe i Bujqësisë është një tjetër sektor i rëndësishëm nën këtë çështje kryesore. Kemi mbështetur fermerët e vegjël dhe Ndërmarrjet e Mesme të Vogla në modernizimin e bujqësisë, zgjerimin e turizmit rural dhe kemi përdorur biodiversitetin e

fokus të veçantë duhet të ketë edhe biodiversiteti dhe burimet natyrore, si elemente të rëndësishme nga ku mund të përfitohet shumë, kur shfrytëzimi bëhet në mënyrë të qëndrueshme.

Ajo nënvizon se GIZ është angazhuar me institucione partnere në nivel kombëtar dhe lokal, për të zbatuar modele që mund të shërbejnë si një udhërrëfyes për të ardhmen dhe sektorët ku janë zbatuar janë nga më të ndryshmit.

Së pari, le të themi diçka për GIZ sa i takon kontributit në Shqipëri gjatë viteve, si dhe fushat që kanë qenë më në fokus...

Gjermania është donatori më i madh bilateral në Shqipëri dhe GIZ ka qenë në terren, duke zbatuar projekte që nga viti 1988, çka na bën në një partner të besuar për zhvillim të qëndrueshëm për më shumë se 30 vjet tashmë.

Së bashku me institucionet

Skema Kombëtare, 2933 aplikantë përfitues për mbështetje në bletari

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton se, të 2933 fermerët në shkallë vendi, aplikantë në Skemën Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë 2022 “Për mbarëshkrimin e bletarisë”, janë përfitues të kësaj mase.

Sipas MBZHR, aktualisht deri tani janë financuar rreth 1037 bletarë me një fond total prej 121 milionë lekë për rreth 121 mijë koshere bletësh në prodhim.

Këtë vit janë 20% më shumë fermerë të kualifikuar që përfitojnë nga Skema Kombëtare, për Masën 7 të mbështetjes në Bletari.

Bletaria renditet e dyta, pas blegtorisë, për sa i takon numrit më të madh të aplikimeve, por edhe numrit të fermerëve përfitues.

Skema Kombëtare me 37 milionë dollarë ka në fokus

në bujqësinë shqiptare. Skema Kombëtare është



përmirësimin e strukturave të prodhimit në bujqësi nëpërmjet rritjes së nivelit të bashkëpunimit midis fermerëve, të mundësuar rritjen e nivelit të formalizimit

një ndër politikat mbështetëse financiare, që zbaton qeveria prej disa vitesh për mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë në vendin tonë.

Historia frymëzuese e Markelianit

Dy përbërës sekret: ëndrra të mëdha dhe orientimi i duhur!

Markelian Cervanaku

“Përvoja ime në emisionin “Puna që Dua” ishte shumë e bukur dhe me emocion, sepse aty filloi rrugëtimi i profesionit tim”, thotë Markeliani energjik teksa tregon se si jeta e tij ndryshoi kur u konsultua me këshilluesit e karrierës të programit “Puna që Dua” dhe

të jetë më i mirë-informuar dhe ndryshimi më pak i frikshëm. Markeliani, edhe pse kishte ëndërruar për profesionin e parukierit, e kishte menduar si një ëndërr që nuk i përkiste, ndaj kjo ishte prova e tij e parë dhe e guximshme për t’iu afruar profesionit shumë të

të gjatë nën mbikëqyrjen e profesorit dhe më pas punoi aty deri sa vendosi të hapë parukerinë e tij. “Biznesi im sot është një sallon unisex ku unë ushtroj profesionin e parukierit”, tregon Markeliani, rasti i të cilit ishte shprehëdhënës se si një i ri mund të

“Ja ku vjen dita, kamera ndizet, dhe Markeliani së bashku me një konkurente tjetër hyjnë në sallonin e parukierit të famshëm dhe profesionist Ardi Borova, i cili i pret të rinjtë me një dashamirësi mbresëlënëse. Pasi dy të rinjtë i nënshtrohen provave në të cilat profesor Ardi i teston, Markeliani ra në sy sepse ishte detajist, i shkathët dhe i shpejtë mjaftueshëm në raport me krehërin, gërshtëret etj., kritere të rëndësishme për punën e parukierit.

mori vendimin të bëhej pjesë e këtij formati televiziv.

“Puna që Dua”, është një emision që ka fokus orientimin në karrierë. Emisioni

dëshiruar.

“Emisioni ‘Puna që dua’ më ndihmoi shumë sepse më bëri të sfidoja veten tek një nga sallonet më të mira në

gjejë veten duke ndryshuar rrjedhën e karrierës, nëse merr orientimin e duhur. Emisioni ‘Puna që dua’ me fokus orientimin e të rinjve në karrierë, ia dha këtë mundësi.

Ka shumë të rinj të cilët nuk ndjekin ëndrrat e tyre, shpesh sepse janë mosbesues ndaj mundësive të punësimit, shpesh sepse profesione që ata parapëlqejnë mund të paragjykojnë apo edhe sepse ndjekja e ëndrrave do të thotë të ndryshosh rrjedhën e karrierës në të cilën ke investuar tashmë kohë, mund dhe para.

Rasti i Markelianit na tregon se duhet guxuar, duhet patur besim tek vetja dhe tek aftësitë që kemi. Kjo, e kombinuar me orientimin e duhur, mund të jetë një nga çelësat e suksesit për secilin prej nesh në tregun e punës.

Markeliani e pati këtë mundësi nëpërmjet orientimit nga emisioni ‘Puna që dua’, ndërkohë që të rinjtë sot mund të orientohen duke vizituar zyrën e karrierës të Bashkisë Tiranë e cila është e hapur për të gjithë të rinjtë, apo zyrat e karrierës pranë universiteteve nëse ky shërbim ofrohet pranë universitetit të tyre, apo edhe shërbime më të specializuara, siç ofron platforma Expert Lane.



“Përvoja ime në emisionin ‘Puna që Dua’ ishte shumë e bukur dhe me emocion, sepse aty filloi rrugëtimi i profesionit tim”, thotë Markeliani energjik teksa tregon se si jeta e tij ndryshoi kur u konsultua me këshilluesit e karrierës të programit “Puna që Dua” dhe mori vendimin të bëhej pjesë e këtij formati televiziv.

“Puna që Dua”, është një emision që ka fokus orientimin në karrierë. Emisioni është konceptuar në formën e një reality show ku dy të rinj provojnë një ditë pune në një profesion të caktuar. Pavarësisht se emisioni ka qenë i hapur për të gjithë të rinjtë pjesëmarrës, ka patur një fokus më të veçantë tek të rinjtë që sapo i janë bashkuar tregut të punës dhe kanë nevojë të zhvillojnë aftësitë e tyre, apo të papunët afatgjatë, duke iu dhënë mundësinë të provonin një ditë pune në një profesion që ata kishin dëshirë apo pasion.

është konceptuar në formën e një reality show ku dy të rinj provojnë një ditë pune në një profesion të caktuar. Pavarësisht se emisioni ka qenë i hapur për të gjithë të rinjtë pjesëmarrës, ka patur një fokus më të veçantë tek të rinjtë që sapo i janë bashkuar tregut të punës dhe kanë nevojë të zhvillojnë aftësitë e tyre, apo të papunët afatgjatë, duke iu dhënë mundësinë të provonin një ditë pune në një profesion që ata kishin dëshirë apo pasion.

Markeliani kishte dëshirë të ndiqte kurse në parukeri, por kjo kishte mbetur thjesht një ide që deri atëherë nuk kishte guxuar ta aplikonte. Të rinjtë shpesh hasin në një vendim-marrje të vështirë, siç është të ndryshuarit e rrjedhës së karrierës kur kanë investuar kohë në një drejtim të caktuar. Kjo vendim-marrje ngelet e vështirë në çdo fazë të jetës profesionale, por me informacionin e duhur dhe duke u konsultuar me profesionistë të fushës dhe me profesionistë të zhvillimit të karrierës, ky vendim mund



AKTUALITET

Gjendja e grave në zonat rurale në veri të Shqipërisë

Zona veriore e Shqipërisë e ka përqendruar aktivitetin ekonomik kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në bashki të tilla të vogla si Hasi, Tropoja, Kukësi, Puka, Vau-Dejës apo Malësia e Mad-

Drejtuesja e kësaj qendre, Denada Shpuza, thote se, nga një studim i realizuar nga kjo qendër, megjithëse rreth 96% e punëve në bujqësi kryhen nga gratë, të ardhurat e përfituara nuk administrohen prej tyre.

gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë pasi përbëjnë rreth 55% të forcave të punës, ato drejtojnë vetëm 7% të fermave bujqësore dhe blegtorale të vendit. Kjo, thotë zonja Shpuza, për shkak se grate janë të privuara nga e drejta e pronësisë.

“Në pjesën më të madhe të rasteve grate vazhdojnë të jenë të zhveshura nga e drejta e pronësisë, ç’ka do të thotë se pjesa më e madhe e tyre hasin problematika qoftë për të bërë aplikime, qoftë për të hapur një biznes, apo për të drejtuar një biznes në këto prona, të cilat vazhdojnë të mos jenë në emrin e tyre”, thotë ajo.

Problematikave që dalin nga territori, si mungesa e transportit, ujit të pijshëm, mungesa e qendrave shëndetësore 24 orëshe si dhe e çerdheve dhe kopështëve me drekë, megjithëse janë shqetësim i të gjithë komunitetit, së pari ato rëndojnë mbi jetën e grave dhe vajzave të zonave rurale.



GJENDJA E GRAVE NË ZONAT RURALE NË VERI TË SHQIPËRISË

facebook.com/zeriamerikes

@zeriamerikes

he pjesa më e madhe e të punësuarve dhe vetëpunësuarve janë grate dhe vajzat.

Siç thotë punëtorja Nexhmije Plangaj, ato përballen çdo ditë jo vetëm me punët e shtëpisë, por edhe me vështirësitë e punës në bujqësi.

“Të gjitha, që jemi këtu, vijmë nga Postriba, vijmë për nevojat tona pasi nuk kemi punë”, thotë ajo.

Situata e krijuar këtë vit, për shkak të agesionit të Rusisë në Ukrainë, ka shtrirë ndikimin e vet edhe në sektorin e bujqësisë me rritjen e çmimit të naftës dhe imputeve bujqësore, por edhe me vështirësitë e krijuara për shitjen e prodhimeve bujqësore. Punëtorja Shpresa Mustali thotë se kjo situatë po rëndon edhe në jetën e grave të zonave rurale.

Me mbështetjen e BE-së, qendra e gruas “Hapat e lehtë” po punon për identifikimin e problematikave të grave dhe vajzave në pjesën më të madhe të bashkive në veri të Shqipërisë.

“Nga studimi rezultoi që grate dhe vajzat punojnë shumë në bujqësi dhe blegtori, krahas punëve të shtëpisë. Dhe, në pjesën më të madhe të kohës janë grate ato që bëjnë punët në



Zëri i Amerikës NEXHMIJE PLANGAJ

PUNËTORE NË BUJQËSI

zeriamerikes.com

facebook.com/zeriamerikes

bujqësi dhe blegtori. Eshhtë ajo puna e padukshme sepse, pavarësisht se siguron të ardhurat e familjes, vazhdon që këto të ardhura të menaxhohen nga burrat”, thotë zonja Shpuza.

Megjithëse në Shqipëri

Ndaj, sipas drejtueses së qendrës së gruas “Hapat e lehtë”, bashkitë dhe njësitë administrative, duhet t’i kushtojnë më shumë vëmendje përmirësimit të këtyre problematikave.

Agronomi në Dashan të Dibrës që e ka fokusuar investimin në kërkesat e tregut

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ishte në fshatin Dashan të Dibrës, ku vizitoi fermën e Ergysit, një djalë largpamës, që me ide të qarta pas përfundimit të studimeve për Agronomi, fokusoi gjithë energjinë te tokat e familjes.

Krifca shprehet në një postim në rrjetet sociale se “Ergysi punon me të atin 12 hektarë tokë dhe kujdeset për rreth 20 krerë lopë, për të cilat ka marrë edhe mbështetje nga qeveria shqiptare”.

Në bashkëbisedim me ministren, Ergysi rrëfëu një fakt shumë interesant, atë të studimit të tregut të shitjes së produktit përpara investimit në pemtëri duke zgjedhur varietetet e dardhës dhe të mollëve, si “Santa”, “Fuji” dhe “Starking”.

Ky hulumtim, nënvizoi Krifca, i eliminon barrën e

vëmendja e tij, ashtu si edhe objektivat tonë, janë fokusuar



gjetjes së tregut të prodhimit, pasi thotë se të gjithë produktin e ka të kontraktuar në një nga pikat e grumbullimit në vend, e ngritur me mbështetjen e AZHBR.

Krifca theksoi se e gjithë

te lehtësimi i proceseve të punës nëpërmjet mekanikës bujqësore, teksa bëri të ditur se, Ministria e Bujqësisë është gjithmonë e hapur për njerëzit punëtorë e dashamirës të bujqësisë.

Braçe: Masat buxhetore rëndësi jetike për bujqit, në kushtet e rritjes së kostove

Deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe deklaroi sot se bujku është bërë një punëtor bujqësor, por jo zot i prodhimit të vet.

Në fjalën e tij në Kuvend, ku ka thirrur në interpelancë ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca për problemet e fermerëve, Braçe tha se “dy probleme janë shumë të qarta dhe të verifikuara gjatë gjithë kësaj periudhe në të gjithë territorin e vendit, sa herë bëhet fjalë për bujqësinë dhe për prodhimin, kostot e prodhimit dhe pa diskutim, çmimet e prodhimit”.

“Të dyja kanë dalë nga duart e bujkut. Edhe pse bujku ka tokë, i zoti i saj dhe ka mjetet e prodhimit, përsëri nuk ka

anuar as kostot e prodhimit, as çmimet e prodhimit. E kanë bërë thjesht një punëtor bujqësor kudo qoftë në Myzeqe, Dibër, poshtë, etj., por jo zot të prodhimit të vet dhe çmimeve të tij, gjithnjë në referencë të rregullave të tregut. Së pari, kostot e prodhimit, qiraja e tokës ku po shtrihet gjithnjë e më shumë bujqësia, është shtrenjtuar. Çmimi i naftës, me ndikim mbi tarifat e shërbimeve nga plugimi, tek korrja, përfshi edhe vaditjen tani në këtë periudhë të nxehtë, plehrat kimike shtrenjtuar abuzivisht në një treg të kapur, plastmas, hekur, tuba, sisteme ujitje, ajrimi, të gjitha të shtrenjtuara. Fara e fidanë, por edhe plehra kimike të shtrenjtuara prej regjimit të TVSH”, nënvizoi Braçe.

Braçe bëri të ditur se çmimet e rritura të gjitha menjëherë, “do të vinin në vështirësi çdo sipërmarrje kudo në Evropë që prodhon në fushë të hapur, por



edhe në serrë”.

“Bujku ynë ka një disavantazh tjetër, përveç kostove të shtuara të lëndëve të para që i duhen domosdo në prodhim dhe që diskuton prapambetjen epike të bujqësisë në këtë vend. Bujku ynë plugon, vadit, mbjell, shërben, vjel e korr me paratë e veta, para të një cikli më parë prodhimi, nëse ka qenë gjithnjë i suksesshëm dhe paratë e emigrimit sjellë nga djem e vajza, por edhe kryefamiljarë për t’u marrë me bujqësi këtu”, theksoi Braçe.

Braçe u shpreh se “bankat serioze nuk financojnë prodhimin, por objektin në përgjithësi, infrastrukturë si serra, magazina, frigoriferë, mjete etj. Prodhimin e grurit, misrit, primeve, nuk i fi-

nancon dot asnjë, përveç se buxhetet familjare të bujqve. Institucionet jo banka kreditojnë edhe prodhimin, por interesi i tyre me 39 % dhe

arrin deri në 171 %, për kredi të shpejta që i nevojiten bujkut për të financuar gjithë ato procese nga punimi i tokës tek vaditja”.

“Masat buxhetore marrin një rëndësi jetike, tashmë edhe nën goditjen e rritjes së çmimeve të lëndëve të para, abuzimit me çmimet gjithashtu. Doja të dëgjoja ku jemi me pagesat sipas këtyre masave mbështetëse, pak janë në gjykimin tim, por janë 3.7 miliardë lekë. Tani është koha e një bilanci ku jemi me pagesat dhe sa ndihmë po u japim ekonomive bujqësore kudo ato ndodhen. Së dyti, çmimet e prodhimit janë thuajse në trendin e një viti me parë, e pse jo, më të ulëta edhe një pjesë e tyre”, tha Braçe.

Çmimet e produkteve bujqësore, Krifca i përgjigjet Braçes: Ne besojmë te tregu

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në interpelancën e saj parlamentare iu përgjigj deputetit Erion Braçe në lidhje me akuzat për çmimet e tregut, duke theksuar parimet e një tregu të lirë që operohet në vendin tonë.

“Ministria e Bujqësisë ka në dorë instrumente të cilat janë në pajtim me parimin e një tregu të lirë, ku çmimi përcaktohet nga kërkesa dhe oferta dhe nuk

është detyra e shtetit të ndërhyjë në këtë çmim. Sigurisht, çmimet që ju përmendni nuk marrin parasysh kostot e grumbullimit, seleksionimit, transportit etj. Unë do preferoja që t’i orientojmë politikat tona zhvilluese aty ku ne mund të dimë ta bëjmë punën tonë, jo duke ndërhyrë në treg”, tha Krifca.

Ministrja riktheqoi se ky vit ka pasur buxhetin më të lartë të dhënë ndonjëherë për fermerët

dhe zhvillimin rural.

“Nuk ka ndodhur kurrë që ne të kemi pasur në skemën kombëtare 30 mijë përfitues në datën 7 korrik. Skema është përthithur 10-15 %. Mund të bëjmë analizën se sa fermerë kanë aplikuar. Keni shumë të drejtë të kërkonit më shumë buxhet. Duhet më shumë buxhet, por ky vit ka buxhetin më të lartë ndonjëherë”, deklaroi Krifca.

Krifca: Rreth 50% të nevojave për grurë i prodhojmë në vend

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bëri të ditur se, aktualisht Shqipëria nuk ka një mungesë të produkteve ushqimore apo abuzim të tepërt me çmimet, në kushtet e krizës që ka përfshirë tregjet ndërkombëtare nga lufta në Ukrainë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha në një intervistë televizive se, qeveria mori masa duke ngritur Bordin e Transparencës për të ndaluar abuzimin me çmimet dhe vuri në dispozicion për importuesit instrumentin e garancisë bankare.

“Momentalisht nuk kemi një mungesë të produkteve ushqimore në tregje. Sigurisht Bordi i Transparencës së çmimeve ka pasur ndikimin e vet me sigurimin dhe vënien në dispozicion të instrumentit të garancisë bankare që iu vihat në dispozicion të importuesve si për vajin dhe për të frenuar rritjen e çmimit dhe abuzimin dhe për të garantuar që këto produkte nuk do të mungojnë”, tha Krifca.

Sa i përket krizës së grurit, Krifca u shpreh se Shqipëria nuk ka një varësi totale nga

Ukraina apo Rusia për këtë produkt, por po mundohet të sigurojë tregje të tjera, por që është përballur me çmime të rritura në bursa.

Ministrja deklaroi se, “Shqipëria rreth 50% të nevojave për grurë i prodhon në vend dhe nga Ukraina vinte rreth 40%. Tashmë është dashur që importuesit e grurit ta sigurojnë grurin nga tregje të tjera ku mund të kenë hasur dhe çmime më të larta. Ka një efekt zinxhirë kjo krizë dhe në produktin final, por që po e monitorojmë në çdo hap”.

Kompanitë përpunuese të qumështit paralajmërojnë përsëri shtrenjtim të çmimeve në korrik

Nga muaji korrik pritet të ketë sërish rritje të çmimeve të bulmetit në vend

Kompanitë përpunuese janë në vështirësi për gjetjen e qumështit në vend, pasi prodhimi është me rënie. Mungesa e qumështit është krijuar nga shtrenjtimi i lëndëve ushqyese për kafshët.

nga fermeri. Edhe ne jemi të detyruar të rrisim çmimin e produkteve në përqindje të rritjes së qumështit. Nga janari i këtij viti po punojmë me marzhe shumë të ulëta fitimi për

lekë me TVSH, kurse tani po blihet 90 lekë me TVSH.

Nga 1 qershori në treg u aplikua edhe një tjetër rritje e çmimeve të bulmetit. Disa operatorë rritën çmimit 6% deri 7%. Ketë vit secili operator ka rritur çmimet e produkteve të bulmetit dy herë, në periudhat mars-prill-qershor.

Sakaq mungesa e prodhimit ka pamundësuar edhe magazinimin e qumështit, ku për në muajt e pranverës prodhohej djathi i bardhë dhe kaçkavall.

“Jemi në vështirësi për gjetjen e qumështit. Në këto kushte e kemi të pamundur të magazinohet qumësht, sepse nuk ka. Mungesa e prodhimit nisi që në stinën e pranverës. Tani në verë i kemi magazinat bosh. Nga Serbia, Kosova dhe Italia nuk ka më tepër qumështi. Jemi në kushtet që prodhojmë dhe shesim, nuk magazinohet dot. Qumësht lope nuk ka më, po zhduket edhe ai deles. Nëse do të rritet përsëri çmimi i qumështit jemi të detyruar të rrisim sërish çmimet, por rrezikojmë konsumin. Në të kundërt do ulim prodhimin”, pohoi për Monitor një tjetër përpunues i qumështit.

Nga 1 korriku me paketën e re fiskale të 2022 do të zbatohet edhe akcizën e re për gazin. Do të shtohen 6 lekë/litër taksë që do të përballohet nga industria.

shkak të rritjes së kostove të prodhimit,” thotë ai.

Më 25 prill fabrika e qumështit “Vita” rriti çmimet nga 9 deri 11 % të kosit, djathi të deles dhe të lopës. Edhe në atë rast, rritja erdhi për shkak të shtrenjtimit të qumështit të fermerit.

Tendenca rritëse e qumështit të blerë nga fermeri këtë vit ka qenë e lartë në raport me 2021. Vjet qumështi i lopës është blerë nga fabrikat 58-59 Lekë/litër me TVSH, kurse tani po blihet maksimalisht 76-77 Lekë/litër me TVSH. Qumështi i deles nga 90 lekë me TVSH, kurse tani po blihet 140 Lekë/litër me TVSH. Kurse çmimi maksimal i qumështit të dhisë ishte 60

Taulant Pupa administrator i kompanisë “Vita” u shpreh për “Monitor” se nga data 1-15 korrik do të rritet përsëri çmimi i qumështit që blihet nga fermerët. Arsyja e rritjes së çmimit të qumështit nga korriku do të jetë nga shtimi i kostos të përpunimit të ushqimit të kafshëve e ndikuar nga shtrenjtimi i naftës.

“Me nisjen e sezonit të ri të korrave të grurit do të rritet kostoja e përpunimit të ushqimit të kafshëve. Çmimet për lidhjen e topit të kashës nga 50 lekë do të arrijnë në 80 lekë, për shkak të shtrenjtimit të çmimit të naftës. Kjo do të ndikojë për rritje tjetër të çmimit të qumështit

Mundësi e “artë” financimi për kompanitë e peshkimit - Kriteret/ Cilat përfitojnë grante deri në 50 % për investime në anije

Kompanitë e peshkimit kanë dy javë afat për të aplikuar për grante të vëna në dispozicion nga Bashkimi Europian me qëllim kryerjen e investimeve në anijet e tyre. Në kuadër të projektit “Support to Fishery Sector in Albania” nën IPA 2016 është hapur thirrja e tretë e mbështetjes ku janë vendosur në dispozicion 720 mijë euro dhe afati i fundit është data 30 Qershor.

Përfituesi i Skemës së Grantëve të Investimeve në Peshkim është çdo individ ose pronar i kompanive të anijeve të peshkimit të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit në Shqipëri, dhe që zotëron Numrin Unik të Identifikimit (NUI). Aplikimi pranë Programit mund të paraqitet nga pronarët individualë të anijeve të peshkimit si dhe pronarët e kompanive të anijeve të peshkimit. Çdo përfitues ka të drejtë të aplikojë për një ose më shumë grante.

Vlera e mbështetjes do të mbulojë maksimumi 50% të shpenzimeve totale të pran-

ueshme të Aktivitetit. Çdo grant i kërkuar duhet të jetë ndërmjet vlerave minimale prej 2,500



EURO dhe maksimumale: 60,000 EURO. Sipas kriterëve të përcaktuara në program, periudha e ekzekutimit të kontratës (përfshirë blerje, instalimin dhe pagesën përfundimtare tek përfituesi) do të kryhet brenda 6 muajve nga data e fundit e nënshkrimit të kontratës nga palët. Por cilat janë dokumentet që duhet të dorëzohen?

Dosja që duhet të depozitohet pranë Ministrisë së Bujqësisë

duhet të përmbajë: Formularin e Aplikimit për Grant të plotësuar sipas modelit të dhënë, kopjen

duhet të përmbajë: Formularin e Aplikimit për Grant të plotësuar sipas modelit të dhënë, kopjen

duhet të përmbajë: Formularin e Aplikimit për Grant të plotësuar sipas modelit të dhënë, kopjen

e licencës së veprimtarisë së peshkimit, kopjen e dokumentit të regjistrimit të biznesit, oferta të krahasueshme të dhëna për investimin e propozuar, nga të paktën tre furnitorë, përfshirë broshurat mbështetëse, dhe Deklaratën e Nderit. Të gjithë dokumentet e sipërpërmendura të cilat e bëjnë një subject që të kualifikohet, do të duhet të dorëzohen edhe në format digjital (CD).

“Ngërçi” i borxheve të grumbulluesve shqiptarë - Propozimi: Kamatëvonesë për ata që nuk paguajnë fermerët e blegtorët!

Nëse grumbulluesi apo përpunuesi i prodhimeve bujqësore do t’ua vonojë pagesën fermerëve e blegtorëve, këta të fundit mund të aplikojnë kamatëvonesën në faturën përfundimtare që duhet paguar.

Kjo është ajo që synon një amendament i propozuar në Kuvend nga deputeti Erion Braçe.

Projektligji propozon disa shtesa në ligjin “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, me qëllim rregullimin e çështjes së kryerjes me shumë vonesë të pagesave që rrjedhin nga transak-

sionet tregtare mes prodhuesve bujqësore dhe ndërmarrjeve tregtare që grumbullojnë, përpunojnë, eksportojnë produkte bujqësore.

“Ndryshimet e propozuara parashikojnë njohjen dhe përfshirjen edhe të prodhuesve bujqësorë si subjekte të ligjit, me qëllim zgjidhjen e një problematike që ka shqetësuar veprimtarinë e kësaj kategorie dhe që është mos shlyerja apo shlyerja me shumë vonesë e detyrimeve që ndërmarrjet tregtare kanë ndaj tyre” shkruhet në relacionin e nismës së depozituar tashmë në Kuvend.

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve për prodhuesit bujqësore krijon jo vetëm një zinxhir të vonësave në pagesa por ndikon drejtpërsëdrejti në ngadalësimin deri në pamundësi të vijimit të aktivitetit bujqësor e blegtoral në sezonet vijuese.

Përtej këtij fakti, përfshirja e prodhuesve bujqësore e blegtoralë në këtë ligj, sipas nismës, do të nxisë akoma edhe më shumë formalizimin e prodhuesve bujqësorë e blegtoralë si dhe formalizimin e çdo transakcioni në tregjet e këtyre produkteve.

Fermeri italian që la Italinë për Shqipërinë: Çmenduri, tregtarët shqiptarë grurin e vendit të tyre e blejnë në Itali me çmim dyfish

Nuk është i vetmi fermer që vjen nga jashtë për të punuar tokat shqiptare. Michelle Ricci, tre vite më parë la Italinë për të kultivuar drithëra në fshatin Kropisht të Selenicës. Në 150 hektarë tokë Michelle ka mbjellë, grurë, misër dhe tërshërë. Gjatë këtyre viteve fermeri italian, po ndeshet me problemet e bujqësisë shqiptare që sipas tij janë të shumta.

Tregtarët e fabrikave të miellit shqiptarë, grurin kërkojnë ta blejnë me çmimin që nuk mbulon kostot e prodhimit. Nëse toka e Selenicës ndihmon të prodhojë grurë cilësorë, bashkombasit e Michelit, pra tregtarët Italian i japin çmimin

e duhur grurit shqiptar.

“Sot grurin në Foxha mund ta shes me 55 euro kuintalin, ndërsa deri të mërkurën mund të shitet edhe 70 euro. Ndërkohë që në Shqipëri, fermerët po e shesin 36 euro”.

Sipas Michelit, gruri i tij rishitet për të dytën herë nga tregtarët italianë për fabrikat e makaronave në Shqipëri, kësaj me një çmim akoma më shtrenjtë.

“Dhe absurditeti ndodh që janë po tregtarët shqiptarë ata që grurin e vendit të tyre e blejnë në Itali me çmimin më të shtrenjtë për të prodhuar makaronat special”.

Pas tregut, bujku Italian

merakoset për magazinimin e drithërave. “Kam aplikuar për të ngritur një kabanon për të futur të gjithë prodhimin dhe akoma nuk ma kanë miratuar lejen e ndërtimit. Do të detyrohem të shes grurin me çmimin që do të më japin tregtarët italian, pasi nuk mund të rrezikoj që ta lë atë jashtë në natyrë”.

Histori si kjo e Michelit na tregojnë se grosistët e grurit në Shqipëri, e vlerësojnë prodhimin vendas vetëm atëherë kur humb gjurmët e origjinës. Katër tregtarët e mëdhenj janë dakordësuar që grurin shqiptarë ta vlerësojnë 36 lekë për kilogram, ndërsa atë serb 51 lekë.

Kriza e blegtorisë, numri i bagëtive dhe prodhimi i qumështit në rënie të shpejtë me 2021

Braktisa e zonave rurale sidomos moshë të reja po bën që numri i bagëtive të reduktohet me shpejtësi sidomos fermat e vogla me 1 dhe dy krerë. Kjo situatë ka sjellë rënie të gjithë sektorit të blegtorisë edhe në nënproduktet e tjera të mishit dhe qumështit.

Sipas të dhënave të INSTAT që u publikuar sot në vitin 2021 numri i gjedhëve shënoi rënie ,me 7.25 ose 26 krerë lopë më pak se në vitin 2020.

Gjithashtu numri i deleve ra me 5% dhe i pulave me 3.2 për qind. Numri i dhive qëndroi thuhet në vendnumëro, teksa iu pa një rritje e numrit të kohshereve me 10%.

Si rrjedhojë e rënies së numrit të bagëtive u vu re rënie e prodhimit të qumështit 3.7%, mishit me 1.5%, teksa prodhimi i vezëve u rrit me 4.4% dhe mjaltit me 5.1%.

Në vitin 2021, numri i të leshtave është 1,48 milionë krerë. Kategoria kryesore e të leshtave përbëhet nga delet e qumështit me rreth 75,38% ndaj numrit gjithsej të tufës. Numri i të dhirtave në vitin 2021, është 775.337 krerë. Kategoria krye-

sore përfaqësohet nga dhitë e qumështit me 77,26% ndaj numrit gjithsej të krerëve. Në vitin 2021, numri i krerëve të derrave është 159.237 krerë.

Referuar vitit 2021 84,83% e qumështit u prodhua nga lopët, 8% nga dhitë dhe 7,2% nga delet.

Rendimenti mesatar vjetor i qumështit në nivel vendi në 2021, është 3.055 kg për krerë. Prodhimi qumështit nga delet për vitin 2021, është 73.466 tonë.

Rendimenti mesatar vjetor, në nivel vendi i qumështit të deles është 63 kg për krerë. Prodhimi qumështit nga dhitë në 2021, është 80.173 tonë.

Rendimenti mesatar vjetor i qumështit nga dhitë në nivel vendi është rreth 128 kg për krerë.

Prodhimi i mishit peshë e gjallë është 148 mijë tonë, ndërsa prodhimi i vezëve për vitin 2021 është 899 milionë kokrra. Nga ana tjetër prodhimi i mjaltit për vitin 2021 është 4.835 tonë.

Qarqet më përfaqësues lidhur me mbarëshkrimin e gjedhit për vitin 2021, janë Fieri me 17,25% dhe Korça me 11,13% ndaj numrit gjithsej të gjedhëve.

Përqendrimi më i madh i numrit të të leshtave është në


qarkun e Vlorës me 23,74% dhe në qarkun e Korçës me 16,51% ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Përqendrimi më i madh i numrit të dhirtave është në qarkun e Vlorës me 20,93% dhe në qarkun e Gjirokastrës me 11,99% ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Përqendrimi më i madh i numrit të derrave është në qarkun Lezhë me 35,67% dhe në qarkun Fier me 19,31% ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Statistikat e blegtorisë për vitin 2021, mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave blegtorisë dhe prodhimeve blegtorale mbështeten në Programin e Statistikave Zyrtare.

Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarëshkruajnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për ti krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve (procesi është në vazhdimësi)



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në

7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

PORTRET

Nezir Koni, një agronom i madh i bujqësisë shqiptare

Nga Enver Isufi

(Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike).

"Kujtoj me mall emrat e parcelave, kanaleve e urave. Të gjithë zonën e Sukthit dhe Spitallës e kam në mendje si një hartë dextrale, që po të klikosh njëherë prej tyre, më dalin si në film punët që kemi bërë atje. Fotot e mija më të dashura janë ato mbi kalë dhe mbi motoçikletë, me këto dy mjete kam prekur çdo cep të zonës time bujqësore" - N. Koni



në tre tipe organizimi:

Kooperativa të zakonshme, pasuri e grupit, me investime modeste

Kooperativa e Tipit të Lartë, (KTL) të cilin kishin mbështetur

më të mirë nga shteti, të cilat ishin ngritur si një trazicion nga për të kaluar në ferma bujqësore.

Forma e tretë ishin ndërmarjet bujqësore, (NB), ose fermat, të cilat ishin mbështetur akoma më mirë nga shteti si me plehra, mekanikë bujqësore, infrastrukturë rrugore, specialisët, paga më të mira etj.

Nezir Koni shërbeu në një ekonomi bujqësore ndër më të mëdhatë në vend, siç ishte Ndërmarrja Bujqësore (NB) Sukth.

Para se të japim skedën profesionale të Nezir Konit, po japim skendën e fermës ku ai punoi për 21 vjet. Kështu do ta kuptojmë kontributin e tij në këtë ekonomi.

Para e Sukthit u krijua nga Italia në vitin 1926. Sukthi ishte dhënë me koncension për 99 vite shoqërisë Italiane EIAA. (Enti Italiana Agricoltura Albanese). Vila e bukur në kodrën e Sukthit është ndërtuar qysh në atë kohë. Fillimisht nga bonifikimi dhe shpyllëzimi u fituan 900 hektarët e parë të tokës.

Pas çlirimit të Shqipërisë nga Italia dhe Gjermania (Prill, 1939-Nëntori 1944), direkt pas çlirimit, në dhjetor 1944, u themelua nga sheti i ri shqiptar ferma e parë e Sukthit.

Kush ishte ferma e Sukthit si një ndër krenaritë e bujqësisë shqiptare?

- Në vitin 1960, ferma kishte 4000 ha tokë dhe në vitet më të mira 1970, ferma e Sukthit mbillte 12 202 hektarë tokë.

Që në fillim kjo fermë mori si detyrë të furnizonte me produkte bujqësore dhe blegtorale Tiranën, Durrësin dhe eksportin.



Të dhënat statistikore të fermës NB Sukth

- Vepronin 17 sektorë prodhimi, tre prej të cilëve

ishin sektorë të veprimtarive mbështetëse si ato të Mekanikës bujqësore, Ndërtimit, Transportit.

- Kishte 145 brigada prodhimi të ndara me disa profile sipas drejtimit të prodhimit ose shërbimeve.

- Bimët kryesore që mbilleshin ishin: grurë, misër dhe tagjira 3000 ha, perime 300 ha, bimë bishtajore soje dhe fasule, foragjere për blegtorinë 1600 ha, luledielli 350 ha, vreshta 300 ha. Kishte edhe ullishte e pemtore.

- Volumi i prodhimeve kryesore: Drithëra deri në 9000 ton, perime dhe bostanore 7000 ton, rrush 13000 ton, patate 3500 fasule, luledielli 1500 ton.

- Blegtoria: 4200 krerë gjeth, nga këto 1930 krerë ishin lopë për prodhim qumështi. Kishte 12000 shpendë. Rriteshin Derra e dosa si dhe 360 kuaj.

- Mekanika bujqësore: 227 traktorë me 15 kuaj fuqi (HP= Horse Power) dhe 36 autokombajna për korjen e grurit, misrit, jonxhës, pa përmendur mjetet e tjera të transportit dhe të logjistikës.

Punësimi dhe burimet njerëzore të kualifikuara

Në NB Sukth ishin të punësuar rreth 10000 punonjës. Këtu shërbenin 873 specialistë me arsim të mesëm dhe 96 specialistë me arsim universitar

Këtu punuan direkt ose kontribuan në forma të ndryshme specialistë që me vite njihen si personalitete të bujqësisë shqiptare me emër në të gjithë vendin.

Ky ishte profili NB-së së madhe të Sukthit, si një nga më të mëdhatë në Shqipëri.

Ferma me potencial të madh prodhimi ishte edhe ferma 29 Nëntori në Lushnje, NB Llakatundi dhe NB Frutore Vlorë, ferma e ullishteve dhe agrumeve në Sarandë, NB Vrina në Sarandë, NB 17 Nëntori, NB Gjergj Dimitrovi në Tiranë, NB Kamza në Tiranë, NB Perlat Rexhepi në Shkodër, Ferma e Gosës në Kavajë, NB-ja e Thumanës, NB Maliqi në Korçë, ferma e ullishteve dhe pemëve frutore në Elbasan, etj.

Përkrahur më parë forcën ekonomike të NB.



Sukthit që të kuptojmë më mirë vlerat, punët, sakrificat e bëra nga agronomi Nezir Koni.

Sukthi është vendi ku ai

shërbeu për 21 vite, ku në këtë zonë shërbeu 13 vite edhe si kryeekspert i zyrave të agronomisë, siç i thonim në atë kohë si kryeagronom.

Leximi i librit të Nezir Konit më bindi mua, se Nezir Koni ishte një personalitet kompleks me vlera shumëplanëshe, të cilat gjithkush do të kishte dëshirë t'i zotëronte.

Fëminjësia e Nezir Konit paraftet për karrierën e tij të ardhshme

Njëherë, të cilët në jetë fitojnë një emër të madh, kjo madhështi i ka rrënjët qysh në fëmëni, qysh në vatrën familjare.

Neziri është djallë i prindërve Bilal dhe Fatime Koni, nga fshati Maminas.

Xha Bilali ishte një burrë, të cilin e respektonte i gjithë fshati.

Gjyshi i Nezir Konit kishte qenë kryeplaku i fshatit që në fillimet e pushteti të ri.

Jeta e organizuar sociale filloi heret në fshatin Maminas, sepse këtu u krijua kooperativa e parë në Shqipërinë e Mesme (në vitin 1947, ose një vit më vonë se sa themelimi i kooperativës së parë në Shqipëri, e cila u themelua në vitin 1946 në Krutje të Lushnjes.

Nga fisi Koni dolën shumë specialistë me emër në bujqësi. Në këtë mjedis familjar dhe fisnor u rrit edhe Nezir.

- Shkolla tetëvjeçare: Shkollën tetëvjeçare e mbaroi në fshatin e tij. Ishte një nxënës i dalluar. Dy fakte për të: kur organizoheshin veprimtari me nxënësit më të mirë të Shqipërisë, Neziri ftohej shpesh. Nxënësit e dalluar grumbulloheshin për të bërë pushime verore në vendet e ish-blokut lindor. Nezirin e ftuan t'i bashkohet nxënësve të dalluar, që u përzgjedhën të shijojnë pushimet verore në Bullgari.

Shkolla e mesme: Rugën e agronomisë Neziri e nisi në vitin 1957, kur ai filloi shkollën e mesme Bujqësore, Golem, Kavajë, një shkollë me emër të madh në atë kohë.

Në atë shkollë jepnin mesim pedagogë, të cilët kishin studiuar të gjithë jashtë vendit dhe kishin njohuri dhe kulturë përëndimore. Këtë shkollë

kanë studiuar në atë shkollë të famshme. Kjo shkollë u themelua nga amerikani Harry Fultz qysh në vitin 1924.

Universiteti Bujqësor:

I filloi studimet e larta në vitin 1961 dhe i mbaroi në vitin 1966.

Edhe studimet në Institutin e Lartë Bujqësor, sot Universiteti i Bujqësisë i përshkruan me nostalgji. Nezir tregon për gëzimin e madh kur mendonin se do të shërbenin si agronomë të lartë dhe sidomos kujton me respekt trupën pedagogjike me personalitete që kishin mbaruar studimet jashtë vendit.

Fillimi i punës si agronom në Sukth

Agronom në Sektorin Rrushkull, Sukth. Udhëtimin e tij të gjatë prej gati 50 vitesh si agronom, Neziri e filloi në sektorin Rrushkull në NB Sukthit. Puna në këtë sektor të madh me 1010 ha tokë nën kultivim, është përshkruar deri në detaje, me plot mbresa dhe kujtime.

Sukthi ishte një ekonomi, ku institucionet shkencore kishin fushat e tyre të kërkimit dhe të demonstrimit të rezultateve të kërkimit.

NB Sukthi, ishte ekonomia kur të gjitha institucionet shkencore aplikonin teknologjitë e reja.

Bashkëpunimi me Institutin e Lartë Bujqësor, Institutin e Perimeve, Institutin e Misrit dhe Orizit, Institutin e Tokave, Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, etj. e kishte kthyer Sukthin në një Universitet të zbatimit të teknikave moderne të prodhimit.

Neziri ishte i përfshirë në të gjitha këto zhvillime

Në Sukth prodhohej fara e domates 10 X Bizon, prodheshin disa kultivarë misri të grupit Rozafa, prodhohej fara e grurit e të gjitha niveleve si: super, super Elitë, fara Elitë dhe fara e gjeneratës së parë (F1), e cila shpërndahej për mbjellje në të gjithë Shqipërinë. Në Sukth kryheshin provat fushore me kultivarët e rinj, me sistemet e ndryshme të plehërimit, të punimeve, ujitjes, përdorimi i herbicideve në mbrojtjen e bimëve nga barërat e egra, etj. Neziri këto probleme i ndiqte deri në detaje.

Ngritja e serrave të perimeve të tipit hollandez

Puna e Nezir Konit u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë kur në vitin 1971, në Xhafzotaj u ngrit blloku i serrave të perimeve prej 9 ha, kryesisht me destinacion për eksport.

Këto serra u porositën në Hollandë. Që nga përgaditja e sheshit të ndërtimit të serrave e deri në zbatimin e teknologjive, mesojmë se kjo ishte një shkollë e vërtetë për prodhimin modern të perimeve. Për ndërtimin e kësaj serre u anga-

zhuan specialistët më të mirë të inxhinierisë së ndërtimit, specialistë bujqësisë, quadro drejtues, e deri te Kryeministri Mehmet Shehu, i pari i partisë Enver Hoxha. Këto serra nën drejtimin e Nezir Konit u bënë baza kryesore e eksportit të perimeve, të cilat përmirësuan shumë të ardhurat financiare të fermës. Shumë intersant është ditari i Nezir Konit kur ai shko për specializim tremujor në Hollandë, për të përvetësuar teknikat e prodhimit të perimeve në këto serra.

Në ditarin e tij prej 90 ditëve në Hollandë, mesojmë përkushtimin e tij për të mësuar nga kolegët hollandezë edhe detajet më të vogla të prodhimit të perimeve në serrat nën xham.

Këto serra u bënë shkolla të përvojës pozitive, nga e cila përfituan të gjithë prodhuesit e perimeve në serra në Shqipëri.

Neziri nuk shërbeu si agronom dhe kreaagronom vetën në Sukth. Në vitin 1976, ferma e Sukthit u nda në dy pjesë të mëdha. Pjesa tjetër ishte NB Spitallë. Këtu Nezirin e caktuan Kryeagronom, që ta konsolidonte Spitallën, si vetë fermën më të mirë NB Sukthin.

Këtu ai shërbeu si Kryeagronom për pesë vite.

Nëziri shërbeu si specialist edhe në Ministrinë e Bujqësisë, i përfshirë në grupet e punës si konsulent për probleme të ndryshme të bujqësisë.

Libri që botova thotë Nezir, sikur me lehtësoi. Shleva një detyrim. Këtë libër e lexoj dhe e rilexoj. Më duket sikur bisedoj më të gjithë këto personazhe, që nga të afërmit e mi e deri tek punëtorët, brigadierët, përgjegjësit e sektorëve, mekanizatorët, kolegët e mi me të cilët kemi ndarë momente dhe vështira dhe gëzimet e sukseseve. Kujtoj personalitete shtetërore që kanë vizituar Sukthin dhe Spitallën. Ishte koha kur Shqipëria vërtet punonte në kushte të vështira të bazës materiale, por punohej si në një familje të madhe, ku secili kryente detyrat e tij. Në Sukth kanë punuar personalitete të bujqësisë shqiptare, të cilat më vonë shërbyen në nivele të ndryshme të piramidës shtetërore. Do doja t'i përmendja emrat e tyre si Sali Kubati, Sulë Gallaj (babë Sula), Miti Bozo, Mihal Dolani, Mina Spiro, Myzafer Kallajxhi, Andon Ikononi, Mentor Përmeti, Demlost Haçi, Ilmi Nikshiqi, Apostol Noçka, Ferid Kora, Shuaip Bilali, Shaqir Zeneli, Fatbardh Harizi, Mustafa Hajdini, Skënder Xhiku, Veip Abazi, Limon Koni, Ruzhdi Pelivani, Bajazit Habibi, Baki Guri, Llukan Tase, Niko Noti, Enver Burgia, Shefki Hoxha, Besim Keçi, Zakina Matathia, Sabri Zalla, Iliua Liperi, Dervish Shahini, Eqerem Basha, Jetgjat Todri, Syrja Hako, Sotir Luarasi, Ndrim Fortuzi, Mithat Mema, Nazmi Disha, Rifat Lila, Alfred Sopi, Gëzim Xhani, Genc Juka, Besim Tusha, Naim Heba, Halim

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

Fermerët në pjesën më të madhe të tyre nuk e konsumojnë menjëherë prodhimin e grurit, por e magazinonjë atë për një kohë të gjatë. Gjatë depozitimit, kokrra e grurit mund të pësojë dëmtime të ndryshme po mund të pësojë edhe ndryshime. Shejat me kryesore në këto raste janë:

- nxejja e kokrrës,
- mykja e kokrrës,
- thartimi i saj,
- ç'ngjyrosja e kokrrës,
- ulja e aftësisë mbirëse të farës,
- ulja e vlerës dhe cilësisë së bukës.

Dy janë faktorët kryesorë të cilët lozin një rol të rëndësishëm gjatë depozitimit, -lagështia dhe temperatura e prodhimit të depozituar.

Kokrra e grurit është një organizëm i gjallë që merr frymë vazhdimisht. Ritmi i frymëarrjes është shumë i ngadaltë, kur kokrra e grurit ka 14% lagështi dhe temperaturë rreth 20 grade celcius. Por kur rritet

Kujtesë këshilluese për fermerët mbi ruajtjen dhe depozitimin e grurit në fermë

temperatura dhe lagështia ritmi i frymarjes është më i shpejtë. Gjatë frymëmarrjes, prodhohet nxehtësi që nuk përhapet shpejt, duke marrë parasysh se gruri është përçues i keq i nxehtësisë. Kur lagështia është e lartë gruri fillon të marrë frymë në mënyrë të theksuar, shtohet temperatura e tij dhe nxehtë, gjatë nxehtësimit temperatura shkon nga 30 deri në 71 gradë celcius.

Në përputhje me të dhënat e fundit mbi këtë problem ka dalë se nxejja e grurit nuk vjen nga frymarja e embrionit të kokrrave, por provokohet nga frymarja e mykeve të ndryshme dhe e mikroorganizmave të tjera, kur kushtet e lagështisë

janë të përshtatshme ritmi i nxehtësimit është i njëjtë si në kokrrat e gjalla dhe në ato pa jetë.

Kur prodhimi i grurit ka në vetvete 16 deri 30% lagështi krijohen kushte ideale për zhvillimin e mykeve, ndërsa kur lagështia është më e lartë se 30%, favorizohet edhe përqindja e baktereve. Bakteret dhe myket shkaktojnë dëme në grurë dhe më vonë prodhojnë nxehtësi.

Kur temperatura arrin në 55gradë celcius pjesa më e madhe e tyre inaktivizohen, përveç mikroorganizmave të cilat prodhojnë spore që nuk ngordhin në këtë temperaturë.

Insektet e depove, përveç dëmeve të tjera shkaktojnë dhe nxejje, sepse duke marrë

frymë lëshojnë nxehtësi dhe lagështi. Kur temperatura arrin në 55gradë celcius, insektet ngordhin

Kurse në temperaturën nën 4 gradë celcius ato bien në gjendje qetësie. Shumëzimi dhe aktivizimi i tyre shtohet shumë në temperaturë mbi 21 gradë C. Kur kokrra e grurit ka lagështi më pak se 10% aktiviteti i tyre entomologjik ndalet plotësisht.

Dëmet nga temperaturat e larta mund të jenë të mëdha. Në temperaturat e larta kokrra e grurit merr ngjyrë gështenjë, shije të djegur, ndërsa kur ajo ngrihet shumë, atëherë merr pamje të karbonizuar. Në këto raste mielli ka cilësi të pa dëshirueshme për bukë. Buka ka volum të vogël, kokrra ngjyroset dhe merr shije dhe erë të keqe. Në këto kushte ju kujtojmë fermerëve të cilët kultivojnë sipërfaqe me grurë, duhet që gruri i shirë t'i nënshtrohet një sërë procesesh siç janë tharja, ventilimi, pastrimi, ambalazhimi dhe magazinimi i prodhimit.

Saktori i Grurit: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Gjatë kësaj periudhe fermerët kultivues të mollës, duhet të intensifikojnë punën e tyre për përfundimin në afat të rrallimit të frutave të mollës. Dihet që një rrallim cilësor dhe ngarkesë optimale me fruta në kurorën e bimës ndikon në rritjen e madhësisë e cilësisë së prodhimit, uljen e periodicitetit dhe rritjen e të ardhurave të fermerit nga shitja e frutave me çmim më të lartë për shkak të rritjes së cilësisë.

Gjithashtu fermerët duhet të vazhdojnë punën e tyre në mbrojtjen fitosanitare të pemëve në luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve tek molla. Trajtimet kimike duhet të bazohen në monitorimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në pemëtore, duke kryer trajtime në kohën e duhur, kryesisht herët në mëngjes, ose mbasditë kur temperaturat janë në rënie dhe efekti i trajtimit kimik në bimë është më i lartë. Bima e absorbon më mirë kimikatin e përdorur në trajtim dhe rrit efektivitetin e tij në mbrojtjen fitosanitare.

Nuk duhet të spërkatim në kohë me erë dhe në kohën e drekës kur temperaturat janë të larta, ku avullimi i solucionit është i menjëhershëm, duke ulur efektin e trajtimit në pemëtore dhe rritur rrezikun nga infeksione të mundshme të kromës, hirit dhe dëmtues si krimbi, merimaga, morri etj.

E rëndësishme në trajtimet kimike në këtë periudhë është mbulimi i gjithë bimës me pesticide gjatë trajtimit, pasi në të kundërt do të kemi vatra infeksioni që do të bëhen burim i përhapjes më pas në pemëtore.

Gjithashtu fermerët duhet të kryejnë edhe punët e sezonit si punimet brenda rreshtave, herbicidim nën kurorën e bimës për luftimin e barërave të këqija.

Në varësi të kushteve meteorologjike dhe gjendjes së lagështisë në tokë të kryejnë ujitjen e pemëtore dhe mbajtjen e lagështisë në tokë në nivelin optimal 60-70% të kapacitetit ujor fushor. Të bëhen plehërime plotësuese me plehra kristalore nëpërmjet ujitjes dhe spërkatjes për rritjen e zhvillimit të frutave, pasi jemi në periudhën e rritjes intensive të tyre dhe bima kërkon ushqim të vazhdueshëm.

Këshilla për fermerët kultivues të mollës, për periudhën korrik 2022

Disa nga plehrat kimike që duhet të përdoren në këtë periudhë nga kultivuesit e mollës janë: 30% N (Azot), 30% K₂O (Potas), Nitrat kalciumi 200 kg/ha, si dhe trajtime gjethore me Seniphos 10 lit/ha me 1 ose 2 aplikime me interval kohor 10 ditore.

Nga dëmtuesit që mund të shfaqen tek molla në këtë periudhë dhe që duhen trajtuar kimikisht janë si më poshtë:

Krimbi i Mollës

(Carpocapsa pomonella)

Është dëmtuesi kryesor i pemëve frutore (mollë, dardhë, ftua etj). Ai ul në masë të ndjeshme prodhimin dhe përkeqëson cilësitë e frutave, duke i nxjerrë ata jashtë konsumimit. Me origjinë nga zona e Mesdheut, ai është i njohur në Evropë qysh nga antikiteti. Insekti i rritur është flutur e familjes lepidoptera. Larva është një krimb me ngjyrë rozë, me kokë ngjyrë kafe të çelur, me gjatësi 1-2 cm, që jeton brenda frutit. Çdo frut ka vetëm një krimb. Pasi mbaron rritjen e saj larva futet në tokë ose në të çarat e lëvores së trungut të bimës dhe formon një mëshkëz, e cila jep më tej fluturën e rritur.

Dimëron si larvë në frutat e prekura dhe mbeburinat e tjera të pemës. Fluturat e para shfaqen në fund të muajit Maj ose fillimi i Qershorit. Gjenerata e dytë paraqitet në mes të Korrikut dhe shfaqja e tyre vazhdon e shkallëzuar deri në Gusht-Shtator me brezninë e dytë. Pasi dalin fluturat, ato vendosin vezët mbi gjethëzat që rrethojnë frytin ose në sipërfaqen e frutit. Fluturat lëvizin natën, në kohë të qetë e të ngrohtë. Vendosja e vezëve ngadalësohet kur temperatura e ajrit është nën 15° C dhe ndërpritet plotësisht në temperaturën nën 12° C. Kur kushtet janë të mira një femër gjatë 10-20 ditëve vendos deri 80 vezë. Inkubacioni i vezëve zgjat 8-18 ditë. Larvat sapo dalin, futen në frutat e mollës dhe aty zhvillohen

për rreth 3-4 javë, pastaj nimfosen në tokë ose në vende të tjera të mbrojtura të pemës.

Insekti ka 1-2-3 breznitë në vit, gjë që varet nga kushtet klimatike të motit. Larva sapo hyn në frutë fillon të bëjë një galeri spirale duke u drejtuar në qendër të frutit. Ajo nxjerr jashtëqitjet nëpërmjet këtyre kanaleve të cilat duken me sy në hyrje të galerisë. Për të luftuar me sukses krimbin e mollës organizohet prognozimi-sinjalizimi i shfaqjes së tij për të përcaktuar afatin optimal të fillimit të trajtimeve. Për këtë qëllim kontrollon fluturimi i fluturave duke i kapur fluturat me anë të ferromoneve kapëse, ose kafazeve prej drite.

Monitorimi më i mirë është me anë të grackave me feromone të cilat bëjnë kapjen e fluturave, ku në bazë të fluturimit maksimal jepet dhe njoftimi për spërkatjen dhe luftimin në kohë të këtij dëmtuesi. Mund të kryhen deri 3 trajtime kimike deri në vjeljen e prodhimit të mollës. Për luftimin e krimbit të mollës përdoren insekticide të ndryshme si: Chlorpyrifos 48 EC, Calypso, Decis etj.

Merimangat e Mollës

Këtu përfshihen një grup i madh specimesh fitofage që dëmtojnë pemët frutore dhe mollën në veçanti. Më të njohurat janë Merimanga e kuqe dhe e verdhë.

Merimanga e kuqe e mollës

(Panonychus ulmi Koch.)

Është dëmtues që shkakton çngjyrosje karakteristike të gjethëve të cilat bëhen kafe ose gri si plumb dhe nuk janë në gjendje të kryejnë asimilimin. Paraziti i rritur është merimangë që nuk dallohet me sy të lirë, por vetëm me anë të një lupe. Trupi është me ngjyrë të kuqe dhe në kurrizin e femrës dallohen njolla të bardha karakteristike të vendosura rresht. Meshkujt janë më të hollë

se femrat dhe larvat dhe kanë vetëm 3 palë këmbë dhe kanë gunga në kurriz nga nxjerrin fije mëndafshi.

Paraziti dimëron në formë vezësh. Veprimtaria e larvës fillon nga fundi i prillit dhe dëmtimet janë të ndjeshme pas lulëzimit kur fillojnë dalin individët e rritur. Numri i brezive varet nga kushtet klimatike. Zakonisht ka 6-8 breznitë gjatë verës.

Nga fundi i korrikut disa nga femrat fillojnë të vendosin vezët e dimërimit mbi degët dhe trungun e pemës, ndërsa femrat e tjera depozitojnë vezët e verës duke siguruar vazhdimësinë e brezive të merimangës deri në tetor. Me ngricat e para zhduken dhe stadet e zhvillimit të parazitit.

Trajtimet e para me akaricide kryhen pas lulëzimit. Gjatë verës kryhen dy trajtime me akaricide me inertvale 12 ditë nga njëra tjetra.

Merimanga e verdhë

(Tetranychus urticae Koch.)

Është shumë polifage dhe e rrezikshme, sepse prek mbi 200 bimë të ndryshme drunore dhe barishtore. Ushqehet më me intensitet në zona të ngrohta dhe mesdhetare. Merimanga e verdhë dallohet shumë mirë nga merimanga e kuqe. Vezët dhe larvat janë të verdha dhe femra ka zakonisht dy njolla të errëta në mes ose në fund. Paraziti dimëron si femër e rritur me ngjyrë portokalli nën lëvores e pemëve dhe vende të tjera.

Në pranverë vendos vezët mbi barishte të ndryshme. Larvat që dalin qëndrojnë aty ose lëvizin në drejtim të gjethëve të reja të pemëve frutore. Breznitë e parazitit zhvillohen me ritme të shpejta dhe çdo femër vendos një numër të madh vezësh.

Veprimtaria e dëmtuesit vazhdon deri në vjeshtë dhe vetëm ngricat e para detyrojnë femrat të futen në vendet e dimërimit të tyre. Kjo specie thur pëlhurat të bollshme e cila mban lagështinë që del nga transpiracioni i bimës, duke krijuar kështu kushte shumë të favorshme për dëmtuesin. Masat e luftimit janë të njëjta me ato të merimangës së kuqe.

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Për fermat e dhenve
Fermerë:

Ju kujtojmë se është piku i fushatës së ndërzimit të dhenve. Për këtë ju këshillojmë që të zbatoni këto hallka teknike si për tufat në shtegtim dhe për ato që nuk shtegtojnë:

- Kryhet qethja e dhenve dhe banjëzimi i tyre kundër parazitozave të jashtme (egzoparazitëve) me preparatet e këshillueshme nga veterineri i zonës dhe sipas rekomandimeve të prodhuesit.

- Bëhet kontrolli i tufës për të zbuluar delet në afsh me deshë kontrolli me përparëse ose të vazoktomizuar dy herë në ditë (mëngjes, mbasditë).

- Bëni ndërzimin e deleve në afsh në kohën që zbulohet dhe përsëriteni mbas 8-10 orësh.

Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta

- Ndërzeni delet me deshë që nuk kanë lidhje gjaku me tufën (babë-bijë, vëlla-motër, eliminimi i bashkëgjakësisë, futja në riprodhim e reproduktorëve me vlerat më të larta racore që disponon ferma).

- Delet e ndërzyera duhet të mos lëvizin në kullotë për 12 orë.

- Ndani delet e ndërzyera në tufa me vete.

- Mos ndryshoni vazhdën e kullotjes dhe vathat ose stallat gjatë fushatës së ndërzimit

(edhe heqja e plehut nga ambientet e qëndrimit të dhenve shkakton ndërprerje të estrusit).

- Evitoni streset (ndryshimet e menjëherëshme të klimës) duke krijuar strehime të thjeshta për mbrojtjen nga shiu dhe dielli.

- Përdorni çdo ditë kripë gjelle 6-8 gr/krerë në ditë. Evitoni përdorimin e kripës së gjellës një herë për disa ditë, sepse përdorimi në këtë mënyrë ndalon afshin dhe shkakton aborte embrionale të deleve të ndërzyera.

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

Këshillojmë që për sigurimin e kripës së gjellës të përdoren blloqe të përgatitura mineralo-vitamins.

- Siguroni ujë të pijshëm në vazhdimësi, jo më pak se tre here në ditë.

- Shikoni gjendjen e deshëve dhe bëni trajtim ushqimor të vaçantë për ta. Për të ushqyerit e tyre përveç kullotjes përdorni 600-700 gr/krerë ushqime të koncentruara.

- Kullotni tufën e deleve në parcela me bimë të përziara leguminoze dhe graminore, sepse nxisin afshin dhe superovulimin (pjellori më të lartë nga delet). Shfrytëzoni kohën e freskët për kullotjen e deleve (herët në mëngjes dhe në darkë vonë sipas mundësive konkrete).

Për sqarime të tjera kontaktoni:
Sotiraq Jankulla cel: 0682630700
E-mail: sotiraqjankulla@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

I njohur ndryshe si "Rrënjëngrënësi i misrit", *Diabrotica virgifera*, u shfaq këtë vit në sipërfaqe të kultivuara me misër në vendin tonë, në fushën e Vurgut, Sarandë.

Ky dëmtues bën pjese në familjen Chrysomelidae. *D. virgifera* dhe *D. barberi*, janë speciet më të rëndësishme të rrënjëngrënësit të misrit në Iowa, një nga zonat më të mëdha të kultivimit të misrit. Një specie e tretë, rrënjëngrënësi i misrit jugor, *D. undecimpunctata*, shkakton shumë dëme ekonomike në rajone të tjera, kryesisht në shtetet jugore të Amerikës. Gama e rrënjëngrënësit të misrit shtrihet edhe në Amerikën e Jugut me emërtimin *Diabrotica speciosa* që ndeshet më shumë në Argjentinë.

Larvat e rrënjëngrënësit të misrit janë ato që mund të shkatërrojnë sipërfaqe të mëdha të misrit nëse nuk trajtohen.

Në Shqipëri vlerësohet si dëmtues i karantinës. Rrënjëngrënësi i misrit është një nga dëmtuesit më të mëdhenj të misrit në Shtetet e Bashkuara.

Përhapja: USA, Kanada, Meksikë dhe në Amerikën e Jugut.

Në Evropë dhe rajonin tonë, prania e këtij dëmtuesi është konstatuar pas viteve 90, kryesisht pranë aeroporteve: Serbia (1992), Kroacia dhe Hungaria (1995), Rumania (1996) Bosnja e Hercegovina (1997), Italia, Mali i Zi e Bullgaria (1998), Sllovakia e Zvicra (2000), Ukraina (2001), Republika Çeke, Austria e Franca (2002), Sllovenia, Anglia, Holanda e Belgjika (2003), Polonia (2005), Gjermania (2007)

Biologjia e dëmtuesit

Diabrotica virgifera

Ky dëmtues jep vetëm një gjeneratë në vit por dëmi që mund të shkaktojë mund të jetë katastrofik. Dëmi shkaktohet si nga larvat ashtu edhe nga insektet e rritura.

Larvat dimërojnë dhe i kalojnë të tre fazat e zhvillimit (vezë, larve, krisalide) në tokë. Larvat shfaqen gjatë muajit maj dhe

Dëmtuesi që mund të kërcënojë prodhimin e misrit

sulmojnë rrënjët e bimës (pranë sipërfaqes) duke reduktuar mundësitë e bimës për tërheqje të lëndëve ushqyese dhe ujit, për rrjedhojë ngadalësim në rritje e zhvillim të bimës. Pamja e rrënjëve merr ngjyre kafe dhe shpesh me tunele. Në shumë raste, këto tunele arrijnë në bazën e bimës. Larvat mund të gjenden në tunelet e rrënjëve të mëdha dhe herë pas here në kurorën e bimës. Ato vendosen afër bazës, duke shkaktuar dëmtime në indet e enëve përçuese duke shkaktuar rrëzim të bimëve. Prania e tyre diktohet lehtësisht nga frenimi i rritjes së bimëve dhe në kushte lagështie të shoqëruar me erë, rrëzim kaotik dhe masiv të bimëve. Insekti i rritur shfaqet nga dekada e dytë dhe e tretë e muajit qershor, vazhdon të ushqehet me pjesët e njoma të bimës (edhe gjatë muajit korrik) kryesisht organet e riprodhimit të bimës si poleni apo pistili (në xhufkë dhe mustak), duke dëmtuar procesin e fekondimit dhe uljen e prodhimit. Insektet e rritur mbizotërojnë në fushat e misrit deri në vjeshtë. Gjatë kësaj periudhe insektet e rritura çiftohen dhe femrat depozitojnë vezët në pjesët fundore të bimës (kryesisht në tokë të thatë afër sipërfaqes). Larvat lëvizin në distanca relativisht të vogla, të rriturit fluturojnë në fusha misri (janë "fluturues të këqij") dhe migrojnë për distanca të shkurtra por edhe të gjata në rast furtunash apo stuhi ere.

Frenimi i përhapjes dhe luftimi

Mund të kryhet përmes kombinimit të masave agroteknike me ato të luftës kimike.

- Qarkullimi bujqësor shfaq epërsi në mbajtjen nën kontroll të popullatës së dëmtuesit dhe në frenimin e përhapjes, (rekomandohet qarkullimi me grurë, thekër, sojë, bizele).

- Korraja e vonë (pas mesit të muajit tetor) minimizon bartjen e insekteve të rritura femra që ende mund të depozitojnë vezë jashtë ngastrës.

- Ndalimi i transportimit të prodhimit jashtë zonës së infektuar.

Lufta kimike fokusohet në eliminimin e insekteve të rritura (kryesisht meshkuj) gjatë fazës së fekondimit duke ulur popullatën aktive ovidepozituese dhe duke minimizuar sasinë e vezëve që mund të depozitohen. Preparatet që paraqesin efekt në luftimin e *Diabroticas* janë ato me bazë lëndë aktive si: klorpirifos-etil, alfa-hipermetrinë, cifluthrin, deltametrin, lambda-cihalothrin dhe klorpirifos-etil + deltametrinë.

Për luftimin e larvave mund të përdoren dezinfektues të tokës por efekti i tyre lidhet ngushtë me kohën e mbjelljes, kohën e qëndrimit të preparatit në tokë dhe fazës së çeljes së larvave. Një trajtim i efektshëm mund të konsiderohet përhapja e dezinfektantit të tokës gjatë kultivimit të dytë të shoqëruar me brazdëhapës. Kjo teknikë mund të përkojë me çeljen e larvave dhe siguron efekt të preparatit.

Prof. as. Kostandin Hajkolla
QTTB Shkodër, qershor 2022



Rrënjë të dëmtuara nga Diabrotica



Rrëzimi i misrit kur dëmtohet nga Diabrotica



D. virgifera



D. barberi,



D. undecimpunctata

Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

Raporti i OKB-së: Numri global i urisë u rrit në 828 milionë në vitin 2021

Raporti i fundit i Gjendjes së Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes tregon se bota po ecën prapa në përpjekjet për të eliminuar urinë dhe kequshqyerjen

